


Respektimi i të drejtave gjuhësore nga komunat e Kosovës

QERSHOR 2014



Mohim përgjegjësie:

Versioni i këtij publikimi në gjuhën angleze është versioni zyrtar. Gjitha versionet e këtij publikimi në gjuhët tjera janë përkthim nga versioni origjinal në anglisht, si dhe nuk janë dokumente zyrtare.

PËRMBAJTJA

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	4
1. HYRJE.....	5
2. KUADRI LIGJOR DHE I POLITIKAVE	6
3. FUNKSIONIMI I ZYRËS SË KOMISIONARIT PËR GJUHËT DHE RRJETI I POLITIKAVE GJUHËSORE	8
4. ZBATIMI NGA KOMUNAT I LIGJIT PËR PËRDORIMIN E GJUHËVE.....	10
4.1. Miratimi i rregulloreve komunale për njohjen dhe përdorimin e gjuhëve në nivel komunal si dhe aktivitetet e vetëdijesimit.....	10
4.2. Vendosja e shenjave, njoftimeve dhe tabelave njoftuese komunale.....	12
4.3. Ofrimi i shërbimeve në shumë gjuhë	14
4.4. Përkthimi me gojë gjatë mbledhjeve të organeve përfaqësuese dhe ekzekutive të komunës, dhe përkthimi me shkrim i materialeve të mbledhjeve të komunës dhe akteve ligjore komunale.....	17
4.5. Përkthimi i faqeve të internetit dhe konkurseve për vende të lira pune të komunave.....	19
4.6. Disponueshmëria e përkthimit me gojë dhe kapaciteti i njësive komunale të përkthyesve	20
4.7. Ekspozimi i emrave të rrugëve dhe shenjave në shumë gjuhë.....	23
5. PËRFUNDIMET.....	24
6. REKOMANDIME.....	25

LISTA E SHKURTESAVE

UA	Udhëzim administrativ
ECMI	Qendra Evropiane për Çështje të Pakicave
ZK Gj	Zyra e Komisionerit për Gjuhët
OSBE	Misioni në Kosovës i Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
UNMIK	Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Për të siguruar një shoqëri shumetnike demokratike dhe pluraliste, kuadri ligjor i Kosovës siguron mbrojtje thelbësore për të drejta të gjera gjuhësore të komuniteteve të ndryshme dhe detyron të gjitha institucionet publike dhe ofruesit e shërbimeve që të respektojnë përdorim dhe status të barabartë të gjuhëve zyrtare. Misioni në Kosovë i Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE) bën monitorim, raportim dhe avokim të rregullt për realizimin e plotë të të drejtave gjuhësore të të gjitha komuniteteve në Kosovë.

Përmes analizimit të praktikave në nivel lokal, ky raport tregon se më se shtatë vite pas miratimit të tij, Ligji për përdorimin e gjuhëve¹ vazhdon të jetë vetëm pjesërisht i zbatuar, si pasojë e burimeve të pamjaftueshme njerëzore dhe financiare, shpeshherë shoqëruar me mungesë të kuptimit të mjaftueshëm të detyrimeve dhe/ose mungesë të vullnetit politik.

Për shkak të këtyre sfidave të konsiderueshme, qasja në shërbime në gjuhët zyrtare dhe gjuhët në përdorim zyrtar për komunitetet në pakicë numerike në nivel komunal vazhdon të jetë problematike. Të gjitha komunat kanë ndërmarrë hapa pozitivë që kanë rezultuar në miratimin e rregulloreve komunale për përdorimin e gjuhëve, por gjuha rome ende nuk është e njohur dhe as e mbrojtur. Fushatat e ndërgjegjësimit për të drejtat gjuhësore janë minimale dhe komunat janë vonuar në emërimin e personave kontaktues për çështje gjuhësore në komunë. Mungesa e konsistencës në vendosjen e tabelave të rrugëve, shenjave të komunikacionit rrugor dhe shenjave në ndërtesa publike gjithashtu mbetet problematike. Vështirësitë në punësimin e shërbyesve civilë me njohuri të gjuhëve zyrtare në komuna, përfaqësimi joadekuat i disa komuniteteve në shërbimin civil dhe trajnimet joadekuate kanë rezultuar në një dështim të gjerë në ofrimin e shërbimeve në të gjitha gjuhët zyrtare dhe gjuhëve në përdorim zyrtar në administratën publike, si dhe përkthime të pamjaftueshme me shkrim të materialeve të takimeve publike. Për më tepër, mungesa e përhapur e përkthimeve të legjislacionit komunal minon statusin e barabartë të gjuhëve zyrtare dhe paraqet një pengesë shtesë për pjesëmarrjen efektive të të gjitha komuniteteve në jetën publike.

Për të korrigjuar këto mangësi, OSBE-ja rekomandon që institucionet e Kosovës të ndajnë burime të mjaftueshme financiare, njerëzore dhe teknike për të mundësuar zbatim të plotë të kornizës ligjore, të shtojnë përpjekjet për ndërgjegjësim të të gjitha komuniteteve të Kosovës për të drejtat e tyre gjuhësore, t'i njohin të gjitha gjuhët zyrtare dhe gjuhët në përdorim zyrtar në nivel komunal, në përputhje me kornizën ligjore të Kosovës, të themelojnë Rrjetin e Politikave Gjuhësore, sipas ligjit, t'i vendosin shenjat komunale dhe rrugore në të gjitha gjuhët zyrtare, t'i përmirësojnë njohuritë gjuhësore të nëpunësve civilë përmes trajnimeve adekuate, si dhe të sigurojnë kushte adekuate të punës për njësitë komunale të përkthimit.

¹ Ligji nr. 02/L-37 për përdorimin e gjuhëve, i shpallur me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2006/51, 20 tetor 2006.

1. HYRJE

Mandati thelbësor i OSBE-së është monitorimi, promovimi dhe mbrojtja e të drejtave të njeriut të komuniteteve të ndryshme² të Kosovës, në të cilat aktivitete të drejtat gjuhësore janë pjesë përbërëse. Përdorimi i barabartë i gjuhëve zyrtare të Kosovës është parakusht për ofrimin e plotë dhe efektiv të shërbimeve për të gjitha komunitetet dhe pjesëmarrjen e tyre të barabartë në çështjet publike, që është element themelor i një shoqërie demokratike dhe shumëkulturore.

Monitorimi i rregullt i OSBE-së, sikurse edhe raportet e mëparshme të OSBE-së³, tregojnë se respektimi i të drejtave gjuhësore nga komunat e Kosovës vazhdon të jetë tejet problematike dhe kërkon vëmendje të veçantë për të siguruar qasje të barabartë në shërbime dhe pjesëmarrje në çështjet publike për komunitetet gjuhësore të Kosovës. Duke e pasur këtë parasysh, ky raport vë në fokus fushat prioritare në të cilat OSBE-ja ka identifikuar mangësi në pajtueshmërinë komunale me kornizën ligjore, në këtë mënyrë duke i siguruar qeverisë së Kosovës një mjet për rritjen sistematike të pajtueshmërinë me detyrimet e saj dhe për t'i dhënë llogari komuniteteve gjuhësore të Kosovës.

Ky raport mbulon gjendjen në 34 komuna të Kosovës⁴ gjatë periudhës nga qershori i vitit 2011 deri në shkurt 2014. Raporti është përpiluar pas shqyrtimit të legjislacionit përkatës, si dhe monitorimit të rregullt në terren dhe hulumtimit të gjerë në terren me qëllim të mbledhjes së të dhënave sasiore (p.sh. ekzistimi i rregullave, mekanizmave dhe praktikave) dhe cilësore (d.m.th. perceptimet dhe vlerësimi i të intervistuarve për sa i përket përmbushjes së detyrimeve gjuhësore) për zbatimin e detyrimeve ligjore nga ana e komunave të Kosovës.

Si pjesë e hulumtimit në terren, OSBE-ja ka mbledhur të dhëna në serinë e parë të intervistave të mbajtura në periudhën korrik 2011 - shtator 2012, vijuar nga seritë e reja të mbajtura në periudhën mars – prill 2013, si dhe janar – shkurt 2014.⁵ Të intervistuarit përfshinin 150 persona që u takonin të gjitha komuniteteve gjuhësore në Kosovë, duke përfshirë udhëheqës komunalë (nënkryetarë për komunitete dhe drejtorë të departamenteve komunale), nëpunës civilë⁶ si dhe banorë⁷ të të gjithave

² Shih për shembull *Dokumentin e Takimit të Kopenhagës të Konferencës së Dimensionit Njerëzor të CSCS* (5-29 qershor 1990) në dispozicion në faqen <http://www.osce.org/odihr/elections/14304> (qasur në shkurt 2014).

³ Raporti i OSBE-së *Zbatimi i Ligjit për përdorimin e gjuhëve nga Komunitetet e Kosovës*, (korrik 2008), <http://www.osce.org/kosovo/32762> (qasur në shkurt 2014); Raporti i OSBE-së *Legjislacioni shumëgjuhësh në Kosovë dhe sfidat e tij*, shkurt 2012, <http://www.osce.org/kosovo/87704> (accessed në shkurt 2014); Raporti i OSBE-së *Vlerësim i të drejtave të komunitetit*, Botimi i tretë, (korrik 2012), <http://www.osce.org/kosovo/92244> (qasur në shkurt 2014).

⁴ Komunat veriore nuk ishin pjesë e anketës.

⁵ Gjatësia e periudhës raportuese akomodon reformën e kuadrit përkatës ligjor dhe institucionet përgjegjëse në mes të përgatitjes së studimit.

⁶ Punonjësit e zyrave komunale për komunitete dhe kthim, zyrtarët ligjore komunalë, zyrtarët komunalë për informim, përkthyes dhe interpretë komunalë.

komunave të anketuara. Në nivelin qendror, OSBE-ja ka kryer intervistë me Komisionerin e Gjuhëve të Kosovës. Rreth një e treta e të gjithë të intervistuarve ishin femra.

Pas kësaj hyrjeje, Pjesa e dytë e këtij Raporti përvijon kuadrin ligjor dhe të politikave që rregullojnë të drejtat gjuhësore në Kosovë. Pjesa e tretë paraqet rolin dhe rëndësinë e Zyrës së Komisionerit për Gjuhët në lehtësimin pajtueshmërisë me detyrimet gjuhësore, si dhe nxjerr në pah rolin e Rrjetit të Politikave Gjuhësore, si mekanizëm mbështetës në nivel lokal. Pjesa e katërt jep një vlerësim të shkallës në të cilën komunat kanë realizuar detyrimet e tyre të hollësishme sipas kornizës ligjore dhe të politikave, si dhe të kapaciteteve e tyre për një gjë të tillë. Pjesët e fundit paraqesin përfundimet kryesore dhe një serë rekomandimesh për institucionet përkatëse dhe palët e interesit me qëllim që t'i ndihmojnë ata në sigurimin e të drejtave gjuhësore të komuniteteve.

2. KUADRI LIGJOR DHE I POLITIKAVE

Me miratimin e Ligjit për përdorimin e gjuhëve⁸ më 2006, Kuvendi i Kosovës ka vënë zotimin mbi institucionet e Kosovës për të siguruar përdorim të barabartë të gjuhës shqipe dhe serbe si gjuhë zyrtare në Kosovë. Ligji për përdorimin e gjuhëve plotëson Ligjin kundër diskriminimit⁹ dhe instrumentet ndërkombëtare për mbrojtjen e pakicave kombëtare dhe gjuhëve rajonale ose të pakicave që janë drejtpërdrejt të zbatueshme në Kosovë, duke përfshirë Konventën Kornizë të Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare¹⁰.

Sipas këtij kuadri ligjor, shqipja dhe serbishtja dhe alfabetet e tyre janë të njohura si gjuhë zyrtare në Kosovë¹¹. Gjuhët e tjera mund ta fitojnë statusin e gjuhëve zyrtare në nivel komunal – me status të njëjtë si gjuha shqipe dhe serbe – nëse komuniteti gjuhësor përbën të paktën pesë për qind të popullsisë së përgjithshme në komunë¹². Përrjashtimisht, Ligji për përdorimin e gjuhëve i jep turqishtes statusin e gjuhës zyrtare në komunën e Prizrenit, pavarësisht madhësisë së komunitetit turk që jeton atje¹³. Komunitetet më të vogla gjuhësore që përbëjnë 3-5 për qind të popullsisë së komunës, apo nëse gjuha në fjalë është folur tradicionalisht, mund ta kenë gjuhën e tyre me

⁷ Gjithsej 76 të anketuar serbë, goranë, shqiptarë, boshnjakë, turq dhe kroatë të Kosovës. Gjithsej 38 anëtarë të komuniteteve janë intervistuar në raundin e parë, ndërsa 38 shtesë janë intervistuar në raundin e tretë.

⁸ Ligji për përdorimin e gjuhëve, shënimi 1, *supra*.

⁹ Ligji i Kosovës nr. 2004/3 kundër diskriminimit, i shpallur me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2004/32, 20 gusht 2004.

¹⁰ Rregulluar në kuadër të nenit 22 të Kushtetutës së Kosovës, 15 qershor 2008.

¹¹ Kushtetuta e Kosovës, shënimi 10, *supra*, neni 5; Ligji për përdorimin e gjuhëve, shënimi 1, *supra*, neni 2.1.

¹² Ligji për përdorimin e gjuhëve, shënimi 1, *supra*, neni 2.3.

¹³ Po aty

status të “gjuhës në përdorim zyrtar” në nivel komunal¹⁴ dhe kështu të marrin shërbime dhe dokumente në atë gjuhë përmes kërkesave individuale.

Ligji për përdorimin e gjuhëve parasheh që institucionet qendrore dhe lokale duhet të realizojnë programe për rritjen e ndërgjegjësimit të publikut lidhur me vetë ligjin dhe të drejtat që ai mbron¹⁵. Gjithashtu, ligji detyron të gjitha institucionet publike dhe ofruesit e shërbimeve që të sigurojnë përdorim dhe status të barabartë të gjuhëve zyrtare në Kosovë, duke rregulluar përdorimin e gjuhëve në institucionet qendrore dhe komunale, ndërmarrje publike, procedura gjyqësore, arsim, media, emra personale, si dhe në sferë private. Sipas këtij ligji, institucionet komunale janë të detyruara t’i përdorin të gjitha gjuhët zyrtare në ofrimin e shërbimeve, të sigurojnë përkthim me gojë në takime të organeve përfaqësuese dhe ekzekutive, përkthime me shkrim të materialeve për mbledhje të komunës dhe të gjitha dokumenteve publike, si dhe t’i vendosin emërtimet e rrugëve dhe shenjat rrugore në të gjitha gjuhët zyrtare¹⁶. Në bazë të nenit 10 të Ligjit për përdorimin e gjuhëve, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal nxjerr udhëzime përkatëse administrative (UA) që përcaktojnë procedurat për të garantuar se pjesëtarët e komuniteteve mund t’i ushtrojnë të drejtat e tyre për ta përdorur gjuhën e komunitetit në institucionet komunale.¹⁷

Për më tepër, Ligji për përdorimin e gjuhëve parasheh themelimin e një organi të veçantë, Komisionin e Gjuhëve, si institucion përgjegjës për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit¹⁸. Komisioni i Gjuhëve u themelua në maj 2007¹⁹. Ministria e Shërbimeve Publike në UA-në e saj nr. 2007/01, e identifikon Komisionin e Gjuhëve si institucionin përgjegjës për përcaktimin e ndëshkimeve administrative për shkelje të dispozitave të Ligjit për përdorimin e gjuhëve²⁰. Reformat ligjore dhe të politikave në vitin 2012 e transformuan Komisionin e Gjuhëve në Zyrë të Komisionerit për Gjuhët, bashkë me bartjen e të gjitha kompetencave përkatëse²¹.

¹⁴ Po aty, neni 2.4.

¹⁵ Po aty, neni 36.2

¹⁶ Ligji për përdorimin e gjuhëve, shënimi 1, *supra*, neni 7–9.

¹⁷ Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, UA nr. 2007/06 për Përcaktimin e procedurave për zbatimin e Ligjit për përdorimin e gjuhëve në komuna, miratuar më 17 gusht 2007, zëvendësuar nga UA nr. 2011/02 (me të njëjtin titull), miratuar më 18 prill 2011.

¹⁸ Po aty, neni 32.

¹⁹ Qeveria e Kosovës, UA nr. 03/2007 për Përbërjen dhe kompetencat e Komisionit të Gjuhëve.

²⁰ Ministria e Shërbimeve Publike, UA nr. 2007/01 për përcaktimin e sanksioneve administrative për shkeljen e ligjit për përdorimin e gjuhëve, 11 prill 2007.

²¹ Rregullorja nr. 07/2012 për Zyrën e Komisionerit për Gjuhët, miratuar nga Qeveria e Kosovës më 4 prill 2012. Në nenin 1.1.2 të rregullores përcaktohet “organizimi dhe strukturimi i Komisionit për Gjuhët, si Zyrë e Komisionerit për Gjuhët, në kuadër të Zyrës së Kryeministrit”. Gjithashtu, neni 32.1 i Rregullores thekson se “pas hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje, shfuqizohet Udhëzimi Administrativ Nr. 03/2007 për përbërjen dhe kompetencat e Komisionit për Gjuhët.”; dhe Neni 32.2 shton se: “Me ditën e emërimit të Komisionerit për Gjuhët nga Kryeministri, në përputhje me rregulloren, Komisioni qeveritar i gjuhëve, shuhet.”

Dokumenti kryesor i politikave i nxjerrë nga Zyra e Kryeministrit është Dokumenti i Analizës së Politikave “Politika e Gjuhëve në Kosovë”²², që paraqet kuadrin ligjor të Kosovës për përdorimin e gjuhëve dhe vlerëson zbatimin e tij nga institucionet e nivelit qendror dhe komunal.



Komisioneri për Gjuhët, Slaviša Mladenović, gjatë një prezantimi mbi përputhshmërinë gjuhësore në nivelin komunal. Punëtori e organizuar nga OSBE-ja në Prishtinë/Priština, 17 tetor 2013 – OSCE/Edon Muhaxheri

3. FUNKSIONIMI I ZYRËS SË KOMISIONERIT PËR GJUHËT DHE RRJETI I POLITIKAVE GJUHËSORE

Komisioni i Gjuhëve është themeluar në vitin 2007 për të siguruar përdorim të barabartë të gjuhëve zyrtare në pajtim me Ligjin për përdorimin e gjuhëve përmes hetimeve, ndërmjetësimeve dhe rekomandimeve, si dhe sanksioneve administrative ndaj subjekteve që shkelin dispozitat e tij²³. Megjithatë, për shkak të mungesës së burimeve të mjaftueshme njerëzore, logjistike dhe financiare, Komisioni i Gjuhëve nuk ka arritur t'i realizojë sa duhet përgjegjësitë e veta. Si rrjedhojë, opinioni publik në përgjithësi nuk ishte në dijeni për ekzistimin e tij dhe të mekanizmave përkatës të ankesave²⁴. Më 2012, OSBE-ja inicioi veprime²⁵ që kontribuan drejtpërdrejt në

²² Zyra e Kryeministrit, Zyra për Çështje të Komuniteteve, Analizë e Politikave II, *Politikat gjuhësore në Kosovë, Zbatimet në lidhje me organet publike*, shtator 2011, http://www.kryeministri-ks.net/zck/repository/docs/Politika_e_gjuheve_shqipe.pdf (qasur më 24 shtator 2013).

²³ Ligji për përdorimin e gjuhëve, shënimi 1, *supra*; UA nr. 2007/01, shënimi 20, më *supra*.

²⁴ Vetëm katër ankesa janë dorëzuar nga viti 2007 deri në mars të vitit 2013.

²⁵ Në maj të vitit 2011, OSBE-ja ka organizuar një punëtori për të diskutuar për mënyrat e fuqizimit të kapaciteteve të Komisionit të Gjuhëve nëpërmjet shkëmbimit të praktikave më të mira ndërkombëtare me Komisionerin e gjuhëve të Irlandës. Kjo nxiti qeverinë e Kosovës që në nëntor

miratimin e një rregulloreje të re të qeverisë për Zyrën e Komisionerit për Gjuhët (ZKGJ). Kjo rregullore trajton problemet e identifikuar lidhur me stafin dhe mungesën e buxhetit duke garantuar staf të dedikuar enkas për ZKGJ, hapësira të mjaftueshme për zyra dhe buxhet. Në përputhje me këto reforma, Komisioneri aktual i Gjuhëve është emëruar në dhjetor të vitit 2012 pas dorëheqjes së paraardhësit të tij. Në shkurt 2014, ZKGJ u bë funksional në nivel bazik, me disa punonjës dhe me një zyrë të pajisur, ndonëse deri në prill 2014 ekipi ende nuk ishte i plotë dhe punësimi ishte në vazhdim e sipër. Në ndërkohë, ZKGJ ka lansuar faqen e saj të internetit²⁶, ka zhvilluar një formular të ankesës në internet, si dhe ka zgjidhur ankesat e pranuar përmes ndërmjetësimit²⁷. Gjithashtu, në shkurt të vitit 2013 ZKGJ paraqiti një sërë rekomandimesh për miratim në Zyrën e Kryeministrit, në formë të vendimit²⁸. Deri në prill 2014 vendimi ende nuk është miratuar. Me mbështetjen e organizatave ndërkombëtare, duke përfshirë edhe OSBE-në, që nga mesi i vitit 2013, ZKGJ gjithashtu është angazhuar në mënyrë aktive në disa aktivitete të komunikimit me publikun dhe të ndërgjegjësimit, që kanë për synim zyrtarët komunalë, shoqërinë civile dhe përfaqësues të komunitetit, për të promovuar njohurinë për të drejtat gjuhësore dhe rolin e ZKGJ-së si mekanizëm për mbikëqyrje dhe ankimim.

Neni 15 i Rregullores për Zyrën e Komisionerit për Gjuhët mandaton të gjitha institucionet publike që të caktojnë një person kontaktues për çështje gjuhësore në nivelin menaxherial dhe të njoftojnë ZKGJ-në përkitazi me këtë emërim brenda 120 ditëve nga hyrja në fuqi e Rregullores në prill 2012. Në të njëjtën kohë, institucionet publike janë të detyruara ta njoftojnë ZKGJ-në me të dhënat e kontaktit të të gjithë asistentëve gjuhësorë, interpretëve dhe përkthyesve që punojnë për ta, me qëllim të krijimit të një Rrjeti të Politikës Gjuhësore për ta ndihmuar Komisionerin e Gjuhëve në zbatimin e mandatit të tij.

Në korrik të vitit 2012, ZKGJ i dërgoi kërkesë zyrtare komunave për emërimin e personave kontaktues për gjuhë brenda afatit gjashtëmuor²⁹. Megjithatë, autoritetet

2011 të themelojë një grup pune për reformimin e Komisionit për Gjuhët (ku OSBE-ja kishte rol vëzhguesit). Bazuar në këtë proces, në prill 2012 qeveria e Kosovës miratoi Rregulloren nr. 07/2012 për themelimin e Zyrës së Komisionerit për Gjuhët.

²⁶ Në dispozicion në shqip në <http://www.komisioneri-ks.org>; në serbisht në <http://www.poverenik-ks.org> (qasur më 20 shtator 2013).

²⁷ Informatat e raportuara nga Komisioneri i Gjuhëve gjatë takimeve bashkërenduese me palët ndërkombëtare të interesit të mbajtur në qershor 2013 dhe janar 2014 në ndërtesën qeveritare.

²⁸ Një grup prej nëntë masave të politikave gjuhësore është dorëzuar nga Komisioneri i Gjuhëve, si pjesë e detyrave dhe përgjegjësi të parapara me Rregulloren nr. 07/2012, neni 18 (1.11). Rekomandimet i bëjnë thirrje qeverisë dhe ministrive që të sigurojnë, ndër të tjera, pajtueshmërinë gjuhësore gjatë fjalimeve publike, përkthimin e faqeve të tyre të internetit në të dy gjuhët zyrtare, si dhe përkthimin e legjislacionit primar dhe sekondar në gjuhët zyrtare. Gjithashtu, ata kërkojnë nga Ministria e Administratës Publike që të sigurohet vendosja e shenjave dygjuhësore në të gjitha hapësirat e institucioneve publike, Ministria e Punëve të Brendshme që t'i zëvendësojë shenjat e kalimit kufitar që nuk janë të përkthyer në gjuhët zyrtare, si dhe Ministria e Infrastrukturës dhe Policia e Kosovës që të ndërmarrin një fushatë ndërgjegjësimi publik për të parandaluar dhe sanksionuar dëmtimet në shenjat topografike.

²⁹ Komisioneri i Gjuhëve të Kosovës, intervistë me OSBE-në, mbajtur në shkurt të vitit 2013, ndërtesa e qeverisë.

lokale ndërmorën veprime minimale deri në gjysmën e vitit 2013, kur Komisioneri aktual për Gjuhët ritheksoi kërkesën për komunat, si dhe pati një qasje proaktive (përmes kontakteve të rregullta dhe vizitave në terren, duke ofruar udhëzime e orientime)³⁰, gjithashtu me përkrahjen e OSBE-së³¹.

Deri në prill 2014, 16 komuna kishin emëruar persona kontaktues, ndonëse jo gjithmonë në nivel menaxhues.³² 18 komunat e mbetura janë ende pa persona kontaktues për gjuhët, kryesisht për shkak të moskuptimit të obligimeve të tyre, megjithatë ZKGj-ja planifikon të ndërmarrë fushatë ndërgjegjësimi me to për të siguruar zbatimin e rregullave.

Përmbledhje gjetjesh

Komisioni i Gjuhëve i themeluar më 2007 për një kohë të gjatë kishte qëndruar joefektiv, si pasojë e mungesës së resurseve adekuate njerëzore, logjistike dhe financiare. ZKGj-ja e sapo themeluar është bërë funksionale në nivel themelor operativ si dhe ka filluar të hartojë një strategji të pranishme më të madhe në publik, për ta informuar popullatën për rolin dhe mandatin e saj. ZKGj-ja dhe komunat nuk kanë përbushur afatin 120-ditor të paraparë me Rregulloren 07/2012 për themelimin e Rrjetit të Politikave Gjuhësore si një prej mekanizmave përkrahës të ZKGj-së.

4. ZBATIMI NGA KOMUNAT I LIGJIT PËR PËRDORIMIN E GJUHËVE

4.1. Miratimi i rregulloreve komunale për njohjen dhe përdorimin e gjuhëve në nivel komunal si dhe aktivitetet e vetëdijesimit

Në përputhje me nenet 2.4 dhe 35 të Ligjit për Përdorimin e gjuhëve, komunat janë të obliguara të miratojnë rregullore të detajuara në lidhje me njohjen e gjuhëve të folura në territorin e tyre, në përputhje me procedurat e përcaktuara me UA-të përkatëse nga Ministria e Administrimit e Pushtetit Lokal.³³

Që të 34 komunat e anketuara tashmë kanë miratuar rregulloret komunale për njohjen dhe përdorimin e gjuhëve. Kjo tregon përparim të rëndësishëm, që prej vlerësimit të

³⁰ Komisioneri i Gjuhëve të Kosovës, intervistë me OSBE-në, mbajtur në shkurt të vitit 2013, ndërtesa e qeverisë.

³¹ Pesë tryeza të rrumbullakëta rajonale janë mbajtur në gjysmën e dytë të vitit 2013, në gjithë Kosovën, të përkrahura nga OSBE-ja, me qëllim të promovimit të ndërvëprimit ndërmjet Komisionerit për Gjuhë dhe autoriteteve komunale, duke lehtësuar kështu caktimin e personave kontaktues për gjuhë në komuna.

³² Deçan, Dragash, Ferizaj, Fushë Kosovë, Junik, Kamenicë, Kllokot, Lipjan, Novobërdë, Obiliq, Podujevë, Prishtinë, Prizren, Ranillug, Shtime dhe Suharekë. Intervistat e kryera me zyrtarët komunalë ndërmjet janarit dhe shkurtit 2014.

³³ UA nr. 2007/06 për përcaktimin e procedurave për zbatimin e Ligjit për Përdorimin e Gjuhëve në Komuna. Në prill të vitit 2011, ky UA është zëvendësuar me UA nr. 2011/02. shënimi 17, *supra*.

parë të OSBE-së për implementimin e Ligjit për Përdorimin e Gjuhëve³⁴. Gjuha turke është aktualisht zyrtare në komunën e Prizrenit dhe Mamushës. Më 2007 dhe 2008, komunat Gjilan, Mitrovicë Jugore, Prishtinë dhe Vushtrri gjithashtu kanë njohur turqishten si gjuhë në përdorim zyrtar. Gjuha boshnjake është gjuhë zyrtare në komunën e Prizrenit, Dragashit dhe Pejës si dhe në përdorim zyrtar në komunën e Istogut (shih tabelën si më poshtë).

Gjuhët zyrtare në Kosovë – serbisht dhe shqip	Gjuhët zyrtare në nivel komunal	Gjuhët në përdorim zyrtar në nivel komunal
<i>Të gjitha komunat</i>	<u>Turqisht</u> <i>Prizren</i> <i>Mamushë</i> <u>Boshnjakisht</u> <i>Prizren</i> <i>Dragash</i> <i>Pejë</i>	<u>Turqisht</u> <i>Gjilan,</i> <i>Mitrovicë e jugut</i> <i>Prishtinë</i> <i>Vushtrri</i> <u>Turqisht</u> <i>Istog</i>

Që prej prillit 2014, asnjë komunë nuk ka njohur gjuhën rome si gjuhë në përdorim zyrtar, edhe pse komuniteti rom në Kosovë tradicionalisht ka folur gjuhën e vet në komunat në të cilat ka jetuar, duke e bërë të kualifikueshme për njohje si të tillë, në bazë të nenit 2.4 të Ligjit për Përdorimin e Gjuhëve.

Përveç disa përjashtimeve të pakta³⁵, shumica e komunave nuk kanë organizuar diskutime publike mbi të drejtat gjuhësore, para apo pas miratimit të rregulloreve komunale, për ta njoftuar popullsinë më mirë me kornizën ligjore. Megjithatë, janë bërë disa hapa pozitivë më 2013, kur disa komuna morën pjesë në iniciativat e përafrimit të ndërmarra nga ZKGj-ja me përkrahjen e organizatave ndërkombëtare, duke përfshirë këtu OSBE-në, me shënjestër shoqërinë civile dhe përfaqësuesit e komuniteteve.

Përmbledhje gjetjesh

Të gjitha komunat kanë bërë hapa pozitivë në miratimin e rregulloreve komunale për përdorimin e gjuhëve. Gjuha boshnjake dhe ajo turke kanë statusin e gjuhëve zyrtare në tri, respektivisht dy komuna, si dhe të gjuhës në përdorim zyrtar në një, respektivisht në katër komuna. Megjithatë, gjuha rome ende nuk ka pranim dhe mbrojtje, përkundër që është folur tradicionalisht. Komunat nuk kanë bërë hapa specifikë në kuptimin e rritjes së vetëdijes publike për të drejtat gjuhësore, edhe pse

³⁴ Raporti i OSBE-së *Implementimi i Ligjit për Përdorimin e Gjuhëve në komunat e Kosovës*, qershor 2008, shënimi 3, *supra*. Sipas raportit, vetëm komuna e Klinës ka miratuar rregullore komunale për përdorimin e gjuhëve (Rregullorja Komunale nr. 01-07-72/07, miratuar më 27 prill 2007).

³⁵ Në Prizren, diskutimet publike janë organizuar para miratimit të rregulloreve komunale për përdorimin e gjuhëve nr. 01/011/3250, 8 mars 2013.

janë shënuar disa përmirësime modeste gjatë vitit 2013, si rezultat i bashkëpunimit të tyre me ZKGj-në.

4.2. Vendosja e shenjave, njoftimeve dhe tabelave njoftuese komunale

Siç është ritheksuar nga Komiteti Këshillues për Konventën Kornizë për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare³⁶, “shfaqja publike e gjuhëve të pakicave ka vlerë të veçantë simbolike pasi portretizon përfshirjen e grupeve të tjera si pjesëtarë të respektuar dhe të mirëpritur të shoqërisë, pra luan rol të rëndësishëm në promovimin e ndjenjës së përkatësisë dhe integritit”.

Në këtë drejtim, shfaqja e mbishkrimeve, njoftimeve, dhe tabelave njoftuese në zyra që ofrojnë shërbime për banorët e komunës (apo persona të zhvendosur) ka dobi të veçantë për komunitetet gjuhësore. Ajo praktikë e mirë është gjithashtu nxitëse për implementimin e Ligjit për përdorimin e gjuhëve, që kërkon që shërbimet të ofrohen në të gjitha gjuhët zyrtare³⁷, që mjedisi i punës të jetë mundësues për përdorimin efektiv të gjuhëve zyrtare³⁸ si dhe që emrat e institucioneve dhe organeve zyrtare të shfaqen në të gjitha gjuhët zyrtare³⁹. Për këtë raport, OSBE-ja ka shikuar shënjimin e brendshëm dhe të jashtëm të zyrave publike komunale⁴⁰, dyerve të zyrave komunale⁴¹ si dhe qendrave të shëndetësisë primare⁴² në qendrën e komunës/qytezës.

Prej 34 komunave, vetëm gjashtë në vazhdimësi kishin të gjitha shenjat publike komunale me shërbimet e ofruara në të gjitha gjuhët zyrtare.⁴³ Njëmbëdhjetë komuna paraqisnin mbi 50 për qind të shenjave në të gjitha gjuhët zyrtare.⁴⁴ Komunitat tjera u gjetën të kishin më pak se 50 për qind të shenjave në të gjitha gjuhët zyrtare.

³⁶ Komiteti Këshillues për Konventën Kornizë për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare, *Mendimi i tretë për Kosovën*, mars 2013, faqe 35.

³⁷ http://www.coe.int/t/dghl/monitoring/minorities/3_FCNMdocs/PDF_3rd_OP_Kosovo_en.pdf.

³⁸ Ligji për përdorimin e gjuhëve, shënimi 1, *supra*, nenet 1.1(ii); 4.2; 7.2; 11 dhe 30.

³⁹ *Po aty*, neni 7.5.

⁴⁰ *Po aty*, neni 9.1.

⁴¹ Zyrat komunale të gjendjes civile, zyrat komunale të regjistrimit civil, zyrat ligjore komunale, zyrat komunale për komunitete dhe kthim, qendrat komunale të shërbimit për qytetarë, zyrat komunale për tatim në pronë, kadastrat komunal, zyrat e regjistrimit të automjeteve, qendrat për punësim dhe mirëqenie sociale; qendrat komunale të biznesit; drejtoritë komunale të administratës; financat; arsimi; kultura, rinia dhe sporti; shërbimet publike/emergjenca; urbanizmi/kadastrat; planifikimi dhe zhvillimi; shëndetësi/mirëqenie sociale; inspeksioni; bujqësi/pylltari; zyrat lokale të Agjencisë Kosovare të Pronës.

⁴² Zyrat e kryetarëve, zëvendëskryetarëve, drejtorëve komunalë dhe zyrtarëve ligjorë.

⁴³ Qendrat e shëndetësisë primare në sistemin e Kosovës.

⁴⁴ Komunitat: Deçan, Gjakovë, Kamenicë, Klinë, Mitrovica e Jugut dhe Novobërdë.

⁴⁵ Komunitat: Dragash, Ferizaj, Fushë Kosovë, Gjilan, Kllokot, Pejë, Podujevë, Prizren, Skenderaj, Shtërpçë dhe Vushtrri.

Sa i përket shenjave në dyert e zyrave komunale, 17 komuna⁴⁵ u gjetën të jenë në përputhje me gjuhët, duke përfshirë katër komuna (Shtërpçë, Kamenicë, Novobërdë dhe Ferizaj) të cilat kishin qenë pjesë e një projekti të OSBE-së për shenjat në dyer, të zbatuar më 2010. Vlen të shënohet që komuna e Prizrenit ka të vendosur rreth 90 për qind të shenjave në katër gjuhë (shqip, serbisht, boshnjakisht dhe turqisht). Në të kundërtën, dhjetë komuna janë gjetur të mos kenë asnjë shenjë në gjuhën përveç asaj të shumicës brenda komunës,⁴⁶ derisa komunat e mbetura janë vlerësuar me nivele të ndryshme të zbatimit të kërkesave të tilla. Zyrtarët nga komuna e Ranillugut⁴⁷, Parteshit⁴⁸, Shtimes⁴⁹ dhe Vitisë⁵⁰ kanë theksuar që planifikojnë të instalojnë shenjat e dyerve në gjuhët zyrtare pasi të kryhet renovimi i ndërtesave komunale.

Përfundimisht, nga 30 qendrat e shëndetësisë primare të vizituara në gjithë Kosovë, vetëm gjashtë janë parë të mbajnë shenja në të gjitha gjuhët zyrtare⁵¹; nga të mbeturat, katër qendra mbanin më pak se gjysmën e shenjave në vetëm një gjuhë, derisa 20 mbanin më shumë se gjysmën (50 për qind apo më shumë) e shenjave të tyre në vetëm një gjuhë.

Monitorimi i rregullt i OSBE-së tregon që arsyet kryesore për moszbatimin e praktikës së vendosjes së shenjave shumëgjuhëshe në komuna ishin mungesa e përgjithshme e vullnetit politik, si dhe mungesa e mirëkuptimit të plotë të obligimeve.



Përmbledhje gjetjesh

Vendosja e shenjave shumëgjuhëshe në zyrat publike komunale i paraprijnë implementimit të obligimit sipas Ligjit për përdorimin e gjuhëve, që është ofrimi i shërbimeve në të gjitha gjuhët zyrtare. Megjithatë, në bazë të vlerësimit të shenjësimit në zyrat komunale dhe qendrat shëndetësore primare, si dhe të shenjave në dyert e brendshme të zyrave komunale, mbi gjysma e komunave nuk vendosin shenja shumëgjuhëshe. Komunat pra inkurajohen të ndërmarrin hapa për të siguruar vendosjen e shenjave, njoftimeve dhe tabelave njoftuese

⁴⁵ Komunat: Deçan, Dragash, Fushë Kosovë, Ferizaj, Istog, Kamenicë, Klinë, Lipjan, Mamushë, Mitrovica e Jugut, Novobërdë, Obiliq, Podujevë, Prizren, Rahovec, Skenderaj dhe Shtërpçë.

⁴⁶ Komunat: Glllogoc, Hani Elezit, Junik, Kaçanik, Malishevë, Partesh, Ranillug, Shtime, Viti dhe Vushtrri.

⁴⁷ Drejtori i drejtorisë komunale të administratës, intervistë me OSBE-në më 13 mars 2013, konfirmuar edhe nga zëvendëskryetari më 3 mars 2014.

⁴⁸ Drejtori i i drejtorisë komunale të administratës, intervistë me OSBE-në më 15 mars 2013, konfirmuar edhe nga zëvendëskryetari më 3 mars 2014.

⁴⁹ Zyrtari komunal i informimit, intervistë me OSBE-në më 20 mars 2013, konfirmuar më 5 shkurt 2014.

⁵⁰ Kreu i Sektorit të Demokratizimit në Komunën e Vitisë, intervistë me OSBE-në më 21 mars 2013, konfirmuar më 4 shkurt 2014.

⁵¹ Komunat: Dragash, Gjakovë, Kaçanik, Kamenicë, Rahovec dhe Viti.

shumëgjuhëshe në të gjitha zyrat dhe objektet publike.

Njoftim në hyrjen e komunës së
Gjilanit/Gnjilane, 28 maj 2014 –
OSCE/Enis Ahmetaj

4.3. Ofrimi i shërbimeve në shumë gjuhë

Neni 7.2 i Ligjit për përdorimin e gjuhëve përcakton që secili person ka të drejtë të komunikojë si dhe të pranojë shërbimet dhe dokumentet publike të disponueshme nga institucionet dhe zyrtarët komunalë në cilëndo gjuhë zyrtare, si dhe që është përgjegjësi e secilit përfaqësues dhe organ ekzekutiv komunal që ta sigurojë këtë. Neni 8.1 më tutje përcakton të drejtën e personave, gjuha e të cilëve është në përdorim zyrtar, që të dorëzojnë parashtresa e dokumente verbale apo të shkruara, si dhe të marrin përgjigje nga institucionet dhe zyrtarët komunalë në gjuhën e tyre, nëse e kërkojnë një gjë të tillë.

Për të vlerësuar shërbimet komunale në shumë gjuhë, OSBE-ja ka intervistuar 76 persona që i përkasin komuniteteve në pakicë numerike në nivel komunal⁵², të cilët kanë përshkruar përvojat e tyre në përdorimin e gjuhës amtare në marrëdhëniet e tyre me autoritetet komunale. Në bazë të dy raundeve të intervistave, me diferencë kohore prej dy vitesh e gjysmë, OSBE-ja nuk ka gjetur ndonjë shenjë të përmirësimit në përdorimin e gjuhëve nga autoritetet komunale në ofrimin e shërbimeve komunale.⁵³

Shumica e të intervistuarve, 40 nga 76, theksonin problemet me marrjen e dokumenteve të shkruara në gjuhën e tyre përkatëse, edhe pse në përgjithësi ata vlerësojnë komunikimin e tyre verbal të jetë më pak problematik. Duke mos lënë anash këtë, disa turq⁵⁴ si dhe boshnjakë⁵⁵ të intervistuar në komunat ku gjuha amtare e tyre është gjuhë zyrtare apo gjuhë në përdorim zyrtar pranojnë të kenë përdorur shqipen apo serbishten në komunikimin e tyre me administratën lokale, duke pranuar dokumentet në njërin prej këtyre dy gjuhëve, për të shmangur zgjatjen e procedurës.

⁵² Tridhjetedy serbë, 14 shqiptarë, 14 turq, 12 boshnjakë, dy kroatë dhe dy goranë. Gjithsej 38 pjesëtarë të komuniteteve janë intervistuar gjatë raundit të parë (korrik 2011 – shtator 2012), derisa 38 persona të tjerë janë intervistuar gjatë raundit të tretë (janar-shkurt 2014). Të intervistuarit janë përzgjedhur në bazë të etnisë dhe gatishmërisë së tyre për të dhënë informata. Disa prej tyre janë partnerë të rregullt apo të afërt me OSBE-në, ndërsa të tjerët janë zgjedhur thjesht para ndërtesave komunale.

⁵³ Po aty.

⁵⁴ Tre turq nga Gjilani (një i intervistuar më 29 gusht 2012, ndërsa dy persona më 5 shkurt 2014), tre turq nga Mitrovica e Jugut (një person i intervistuar më 7 shtator 2012 dhe dy persona më 22 janar 2014), katër turq nga Prishtina (një person i intervistuar më 12 shtator 2012 si dhe tre persona më 15 janar 2014) si dhe katër turq nga komuna e Prizrenit (dy intervista të kryera më 10 shtator 2012 si dhe dy të tjerë më 12 shkurt 2014).

⁵⁵ Katër boshnjakë në komunën e Dragashit (dy intervista të kryera më 7 shtator 2012 dhe dy më 23 janar 2014), katër boshnjakë nga komuna e Pejës (dy persona të intervistuar më 10 shtator 2012, një person më 5 shkurt 2014 si dhe një tjetër më 10 shkurt 2014) si dhe katër boshnjakë nga komuna e Prizrenit (dy intervista të kryera më 5 shtator 2012, një person i intervistuar më 31 janar 2014 si dhe një person më 10 shkurt 2014).

Ndonëse është raportuar që përputhshmëria e komunave në ofrimin e shërbimeve në shumë gjuhë është përmirësuar në vitet e fundit, serbët dhe goranët kanë përmendur vështirësi në komunikimin e tyre dhe marrjen e dokumenteve nga autoritetet komunale, si dhe kanë thënë që shërbyesit e rinj civilë shpesh nuk e flasin serbishten. Serbët⁵⁶ dhe goranët⁵⁷ kryesisht raportojnë probleme që kishin përjetuar me dokumentacionin nga kadastrat komunal, zyrtat komunale të tatimit, klinikat mjekësore (raportet mjekësore, përshkrimet e barnave), zyrtat komunale të regjistrimit civil si dhe qendrat e regjistrimit të automjeteve. Nga ana e tyre, kroatët⁵⁸ raportojnë të jenë përballur me probleme në Gjykatën Komunale në Viti, e cila nxjerr shumicën e dokumenteve të shkruara vetëm në gjuhën shqipe, me pretendimin që dokumentet kryesisht kanë të bëjnë me avokatët, të cilët janë shqiptarë në shumicën dërmuese të rasteve⁵⁹.

Shqiptarët e Kosovës kanë përshkruar përvoja paksa më të ndryshme në komunat ku ata janë numerikisht pakicë. Në Kllokot, të anketuarit⁶⁰ raportuan që administrata komunale i trajton që të dyja gjuhët zyrtare njëllë, dhe se nuk ka probleme sa i përket respektimit të të drejtave gjuhësore. Shqiptarët e Kosovës që u intervistuan në komunat e Mamushës⁶¹ dhe Graçanicës⁶² ishin të mendimit që punonjësit komunal janë përgjithësisht të gatshëm dhe të zotë për të komunikuar në gjuhën shqipe kur nga ta kërkohet ndihmë ose informata, megjithëse, në Graçanicë⁶³, u identifikuan ca probleme që rezultojnë nga numri i pamjaftueshëm i përkthyesve komunalë me shkrim dhe me gojë (p.sh. mungesa e përkthimit gjatë mbledhjeve, vonesat në

⁵⁶ Tre serbë nga komuna e Ferizajt (dy persona të intervistuar më 21 gusht 2012 dhe një person më 5 shkurt 2014); tre serbë nga komuna e Gjilanit (një intervistë e kryer më 29 gusht 2012, si dhe dy intervista të kryera më 5 shkurt 2014); katër serbë nga komuna e Kamenicës (dy intervista të kryera më 28 gusht 2012 si dhe dy më 7 shkurt 2014), katër serbë nga Novobërda (dy intervista të kryera më 27 gusht 2012 si dhe dy më 6 shkurt 2014); tre serbë në komunën e Shtërpçës (dy persona të intervistuar më 7 gusht 2012 dhe një person më 4 shkurt 2014); dy serbë nga komuna e Vitisë (një intervistë e kryer më 14 gusht 2012 dhe një më 3 shkurt 2014); katër serbë nga komuna e Fushë Kosovës (dy intervista të kryera më 9 gusht 2012 si dhe dy intervista të tjera më 14 janar 2014); dy serbë nga komuna e Lipjanit (një intervistë e kryer më 7 shtator 2012 dhe një tjetër më 14 janar 2014); dy serbë nga komuna e Obiliqit (një intervistë e kryer më 11 shtator 2012 si dhe një tjetër më 15 janar 2014); dy serbë nga komuna e Vushtrisë (një person i intervistuar më 7 gusht 2012 si dhe një person i intervistuar më 4 shkurt 2014); si dhe tre serbë nga Rahoveci (një person i intervistuar më 6 shtator 2012, si dhe dy persona të intervistuar më 11 shkurt 2014).

⁵⁷ Dy goranë nga komuna e Dragashit (një person i intervistuar më 6 shkurt 2012 si dhe një person më 23 janar 2014).

⁵⁸ Dy kroatë nga komuna e Vitisë, intervistë e kryer nga OSBE-ja më 23 gusht 2012 si dhe konfirmuar më 5 shkurt 2014, edhe pse të intervistuarit kanë raportuar disa përmirësime që prej mesit të vitit 2013 pas reformës së gjyqësorit si dhe themelimit të Gjykatës Themelore në Gjilan, Dega në Viti.

⁵⁹ Sa i përket monitorimit nga OSBE-ja të rasteve me elemente etnike në Gjykatën Komunale në Viti, gjithmonë ka rezultuar që dokumentet relevante janë përkthyer në gjuhën e palëve.

⁶⁰ Pesë shqiptarë të Kosovës (dy persona të intervistuar më 28 gusht 2012, dhe dy tjerë të intervistuar më 7 shkurt 2014).

⁶¹ Një shqiptar i Kosovës i intervistuar më 30 gusht 2012, një tjetër më 10 shtator 2012, dhe një tjetër më 10 shkurt 2014.

⁶² Katër shqiptarë të Kosovës (dy persona të intervistuar më 12 shtator 2012, dhe dy të tjerët të intervistuar më 11 shkurt 2014).

⁶³ *Po aty.*

nxjerrjen e versioneve në gjuhën shqipe të dokumenteve komunale etj.). Shqiptarët e Kosovës në komunën e Ranillugut raportuan që, përkundër punësimit të disa zyrtarëve komunalë nga radhët e komunitetit shqiptar të Kosovës, vazhdojnë ende ta gjejnë veten në situata të atilla ku u duhet që punonjësve serbë të Kosovës t’ju drejtohen në gjuhën serbe, nga që, përgjithësisht, ata nuk e zotërojnë mirë shqipen⁶⁴.

Vështirësitë e mësipërme vënë në pah ngecjet e vazhdueshme në sigurimin e qasjes së barabartë në shërbime në gjuhët zyrtare, dhe në gjuhët që janë në përdorim zyrtar, për të gjitha komunitetet. Siç ka vërejtur Komisioni Këshillëdhënës mbi Konventën Kornizë për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare⁶⁵, vështirësitë në të cilat hasin autoritetet administrative gjatë punësimit të nëpunësve civilë që i zotërojnë gjuhët zyrtare, të kombinuara me mungesën e kurseve adekuate për gjuhë⁶⁶, janë ndër shkaqet kryesore për këtë. Gjithashtu, siç është theksuar më herët nga ana e OSBE-së,⁶⁷ disa komunitete vazhdojnë të mos jenë të përfaqësuara sa duhet në shërbimin civil, përkundër përfshirjes së klauzolave mbi mosdiskriminimin në legjislacionin për punësimin dhe kuotave të rezervuara për punësimin e pjesëtarëve të komuniteteve nëpër institucione publike.⁶⁸

Përkitazi me këtë, OSBE-ja vë theksin mbi hapat pozitivë që Zyra për Çështje të Komuniteteve pranë Zyrës së Kryeministrit i ka bërë në vitin 2013 drejt ngritjes së një grupi punues mbi punësimin e komuniteteve që janë numerikisht pakicë në nivelin komunal, për të promovuar përfaqësimin e tyre në shërbimin civil dhe ndërmarrjet publike.⁶⁹

Përmbledhje e gjetjeve

Institucionet dhe zyrtarët komunalë nuk po arrijnë ende të sigurojnë që detyrimet mbi përdorimin e gjuhëve të respektohen në shërbimet dhe dokumentet publike, ashtu siç kërkohet me Ligjin mbi përdorimin e gjuhëve. Për më tepër, gjatë tri viteve të fundit komunat nuk kanë bërë asnjë përmirësim të dukshëm në sigurimin e shërbimeve në të gjitha gjuhët e kërkuara. Kjo vjen kryesisht si rrjedhojë e vështirësive për të punësuar

⁶⁴ Dy shqiptarë të Kosovës të intervistuar më 29 gusht 2012, dhe një tjetër i intervistuar më 10 shkurt 2014.

⁶⁵ Komisioni Këshillëdhënës mbi Konventën Kornizë për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare, *Mendimi i tretë për Kosovën*, shënimi 36, *supra*, faqet 9 dhe 33.

⁶⁶ Që nga viti 2012, Komisioneri i Lartë për Pakicave Kombëtare, në bashkëpunim me ZKJG-në, po mbështet një Project për trajnimin e nëpunësve civilë që t’i flasin të dyja gjuhët zyrtare njëllëj. Projekti është zbatuar nga Qendra Evropiane për Çështje të Pakicave (ECMI). Shih Qendrën Evropiane për Çështje të Pakicave në: <http://www.ecmikosovo.org/?p=4529> (qasur në shkurt 2014).

⁶⁷ Raporti i OSBE-së “Përfaqësimi i komuniteteve në shërbimin civil të Kosovës”, dhjetor 2012, <http://www.osce.org/kosovo/99601>.

⁶⁸ Të paktën 10 për qind të nëpunësve civilë në nivelin qendror duhet të jenë pjesëtarë të komuniteteve joshqiptare. Në nivelin komunal. Kuotat duhet të bazohen në përqindjen e komuniteteve në komunën përkatëse në pajtim me nenin 11(3) të Ligjit nr. 03/L-149 për shërbimin civil dhe Rregulloren nr. 04/2010 për procedurat e përfaqësimit të drejtë dhe proporcional të komuniteteve joshumicë në shërbimin civil të Kosovës, 21 shtator 2010, e nxjerrë nga Ministria e Administratës Publike.

⁶⁹ Shih <http://www.kryeministri-ks.net/zck/?page=2,4,132> (qasur më 19 qershor 2013).

nëpunës civilë që i zotërojnë gjuhët zyrtare dhe mungesa e kurseve të gjuhëve, si dhe përfaqësimit të pamjaftueshëm të disa komuniteteve në shërbimin civil.

Për t'i korrigjuar këto dështime, komunat duhet t'i kenë parasysh njohuritë e gjuhëve kur rekrutojnë nëpunës për pozita të administratës publike, dhe të kërkojnë përkrahje nga niveli qendror për t'ju ofruar nëpunësve civilë kurse adekuate të gjuhëve, me qëllim nxitjen e një mjedisi përgjithësisht të favorshëm për përdorimin e të gjitha gjuhëve zyrtare. Veç kësaj, qeveria e Kosovës duhet të përpilojë programe dhe nisma të veçanta të punësimit në administratën publike që dedikohen për gjithë komunitetet e Kosovës, për të siguruar zbatim të plotë dhe efektiv të masave të veprimit pozitiv që kanë për qëllim rritjen e shkallës së përfaqësimit të komuniteteve në shërbimin civil në nivel të komunave, ashtu siç kërkohet me nenin 11 të Rregullores nr. 04/2010.

4.4. Përkthimi me gojë gjatë mbledhjeve të organeve përfaqësuese dhe ekzekutive të komunës, dhe përkthimi me shkrim i materialeve të mbledhjeve të komunës dhe akteve ligjore komunale

Sipas Ligjit për përdorimin e gjuhëve zyrtare, komunat kanë detyrimin për të siguruar përkthim nga njëra gjuhë zyrtare në tjetrën⁷⁰, si dhe nga njëra gjuhë zyrtare në gjuhën e komunitetit tjetër⁷¹, nëse kjo kërkohet. Gjithashtu, në po të njëjtin ligj kërkohet që edhe "shënimet e takimeve dhe shënimet zyrtare të organeve përfaqësuese dhe ekzekutive komunale, regjistrat publikë dhe dokumente të tjera zyrtare, të mbahen dhe nxirren në të gjitha gjuhët zyrtare të komunës."⁷²

Për të fituar një pasqyrë të përgjithshme mbi respektimin e këtyre dispozitave, OSBE-ja ka monitoruar respektimin nga ana e komunave të detyrimit për të siguruar përkthim gjatë mbledhjeve të kuvendit komunal, si dhe pajtueshmërinë e materialeve të mbledhjeve me Ligjin për përdorimin e gjuhëve dhe atë për vetëqeverisje lokale.⁷³

Përmes monitorimit të vet të vazhdueshëm, OSBE-ja ka gjetur që, me disa përjashtime⁷⁴, komunat respektojnë detyrimin ligjor për të siguruar përkthim me gojë gjatë mbledhjeve të kuvendit komunal, kur kjo u kërkohet. Por, shqetësim vazhdon të përbëjë përkthimi me shkrim i procesverbaleve të mbledhjeve, nga që, gjatë vitit 2013 gjithsej 19 komuna⁷⁵ nuk kanë arritur të ofrojnë rregullisht përkthime me shkrim, përkundër detyrimit të tyre për ta bërë këtë pavarësisht se a ka kërkesë

⁷⁰ Ligji për përdorimin e gjuhëve, shënimi i 1, *supra*, neni 7.3 u referohet mbledhjeve të organeve përfaqësuese dhe ekzekutive komunale, si dhe takimeve publike të organizuara nga komuna.

⁷¹ *Po aty*, neni 8.4. Kjo dispozitë u referohet anëtarëve të organeve përfaqësuese të komunës, dhe komiteteve të tyre, anëtarët e të cilave iu takojnë komuniteteve gjuha amtare e të cilave nuk është gjuhë zyrtare e komunës.

⁷² *Po aty*, neni 7.4.

⁷³ Shih nenet 4.4 dhe 4.9, Ligji nr. 03/L-040 për vetëqeverisje lokale, 4 qershor 2008.

⁷⁴ Është gjetur që vetëm dy komuna nuk kanë siguruar përkthim me shkrim rregullisht gjatë vitit 2013, gjegjësisht Graçanicë dhe Mamusha.

⁷⁵ Deçan, Ferizaj, Fushë Kosovë, Gjakovë, Gllogoc, Hani i Elezit, Istog, Junik, Kaçanik, Klinë, Lipjan, Malishevë, Mitrovicë/Mitrovicë e Veriut, Obiliq, Podujevë, Rahovec, Shtime, Suharekë dhe Vushtrri.

për përkthim apo jo. Zyrtarët komunalë dhanë dy arsye për mosrespektimin e detyrimeve për përkthim, e që janë burimet njerëzore të pamjaftueshme dhe fakti që disa komuna kanë shumë pak banorë që nuk i përkasin shumicës numerike dhe, për rrjedhojë, nuk ndiejnë nevojë për përkthimin e shënimeve në gjuhët tjera.

Në mënyrë të ngjashme, sipas kuadrit ligjor, gjithë aktet ligjore komunale duhet të procedohen, miratohen dhe botohen në të gjitha gjuhët zyrtare të komunës.⁷⁶ Rrjedhimisht, komunat kanë detyrimin për të respektuar statusin e barabartë të gjuhëve zyrtare, pavarësisht nga përbërja demografike e komuniteteve që jetojnë në të. Në përputhje me vlerësimin e përgjithshëm të mëhershëm të OSBE-së⁷⁷, që dëshmon se më se një e treta e komunave kanë dështuar që t'i përkthejnë projektaktet ligjore dhe të miratojnë legjislacionin në të gjitha gjuhët zyrtare, aspekt ky vendimtar në kontekstin e pjesëmarrjes së gjerësishtme të komuniteteve në çështjet e komunës, OSBE-ja ka gjetur që 14 komuna vazhdojnë të mos e respektojnë këtë detyrim në të shumtën e rasteve (më pak se 20 për qind e vendimeve apo rregulloreve komunale që i shqyrtoi OSBE-ja ishin në përputhje me detyrimet mbi përdorimin e gjuhëve).⁷⁸ Komunat e Prizrenit, Dragashit dhe Pejës i respektojnë këto detyrime vetëm pjesërisht (rreth 70 për qind të vendimeve apo rregulloreve komunale të shqyrtuara kanë qenë në përputhje me detyrimet mbi përdorimin e gjuhëve), meqë nuk i përkthejnë aktet ligjore në gjuhën boshnjake, derisa 17 komunat e tjera të anketuara janë vlerësuar se respektojnë detyrimet mbi përkthimin (mbi 80 për qind). Gjithashtu, OSBE-ja ka vrojtuar që, madje edhe në ato raste kur ka qenë në dispozicion, vetëm pak komuna kanë arritur që të sigurojnë përkthim plotësisht të kënaqshëm⁷⁹, derisa në disa komuna tjera përkthimi ose nuk ka qenë tërësisht i kënaqshëm ose ka qenë i pasaktë, kryesisht sa u përket dokumenteve të përkthyer nga gjuha shqipe në atë serbe.⁸⁰

Si shkaqe më të shpeshta për dështimin për të siguruar përkthime (të kënaqshme) me shkrim, zyrtarët komunalë kanë përmendur mungesën e burimeve njerëzore dhe financiare, kushtet e dobëta të punës për përkthyesit dhe/ose numrin e pakët të komuniteteve që janë numerikisht pakicë në komunat gjegjëse.

Përmbledhje e gjetjeve

⁷⁶ Ligji për përdorimin e gjuhëve, shënimi 1, *supra*, neni 7.6.

⁷⁷ Shih raportin e OSBE-së *Legjislacioni shumëgjuhësh në Kosovë dhe sfidat e tij*, shkurt 2012, shënimi i 3-të *supra*, faqe 17–19. Ky raport orientohet kryesisht kah akterët e përfshirë në hartimin e legjislacionit shumëgjuhësh, si në nivelin qendror ashtu edhe në atë lokal.

⁷⁸ Deçan, Ferizaj, Gjakovë, Gjiilan, Glogoc, Hani Elezit, Junik, Kaçanik, Malishevë, Mitrovicë e Jugut, Obiliq, Podujevë, Skenderaj dhe Vushtrri.

⁷⁹ “Përkthim i kënaqshëm” nënkupton që teksti i përkthyer të jetë i shkruar shumë bukur dhe i kuptueshëm, dhe të përçojë porosinë e tekstit origjinal. Cilësi e këtillë e përkthimit është vrojtuar vetëm në komunat e Fushë Kosovës, Graçanicës, Kllokotit, Novobërdës, Parteshit, Prishtinës, Ranillugut, Shtimes dhe Shtërpçës.

⁸⁰ Ndonëse teksti është i kuptueshëm, ai ka shumë gabime të përgjithshme në kuptim të sintaksës, përdorimit jo të duhur të germave dhe rasave. Kjo është vrojtuar në komunat e Dragashit, Gjakovës, Gjiilanit, Istogut, Kamenicës, Klinës, Lipjanit, Pejës, Prizrenit, Suharekës, Vitisë dhe Vushtrrisë.

Derisa detyrimi për të siguruar përkthim me gojë gjatë mbledhjeve të kuvendit komunal respektohet në masë të madhe, ende ka shqetësime përkitazi me faktin që më se gjysma e komunave nuk i përkthejnë procesverbalet e mbledhjeve. Gjithashtu, gjysma e komunave nuk e respektojnë detyrimin për t'i nxjerrë gjithë projektaktet dhe legjislacionin komunal në të gjitha gjuhët zyrtare, dhe as atë për të siguruar që këto përkthime të kenë cilësi adekuate. Komunat duhet t'i shtojnë burimet njerëzore dhe financiare për të siguruar përkthim me gojë gjatë mbledhjeve publike dhe përkthimin adekuat me shkrim të të gjitha dokumenteve zyrtare.



Shenjë rrugore në komunën e Parteš/Parteshit, 28 maj 2014 – OSCE/Enis Ahmetaj

4.5. Përkthimi i faqeve të internetit dhe konkurseve për vende të lira pune të komunave

Ligji për përdorimin e gjuhëve i mandaton komunat për të siguruar që të gjitha dokumentet publike të nxirren, mbahen dhe publikohen në të gjitha gjuhët zyrtare.⁸¹ Gjithashtu, autoritetet zyrtare kanë detyrimin për t'i botuar pa asnjë dallim dokumentet zyrtare në të gjitha gjuhët zyrtare në faqet e tyre të internetit.⁸²

Që nga prilli i vitit 2014, të gjitha komunat i kanë faqet e veta të internetit.⁸³ Megjithatë, OSBE-ja ka gjetur që vetëm shtatë sish⁸⁴ janë në pajtueshmëri të plotë me

⁸¹ Ligji për përdorimin e gjuhëve, shënimi 1, *supra*, nenet 7.2 dhe 7.4.

⁸² Ministria e Administratës Publike, UA nr. 03/2011 mbi ueb faqet e institucioneve publike, 24 tetor 2011, neni 9: "ueb faqja dhe informacionet në të, duhet të jenë në pajtim me Ligjin për përdorimin e gjuhëve". [http://map.rks-gov.net/userfiles/file/document_page/Udhezimi Administrativ Nr 03 2011 Per ueb Faqet e Institucioneve Publike an.pdf](http://map.rks-gov.net/userfiles/file/document_page/Udhezimi_Administrativ_Nr_03_2011_Per_ueb_Faqet_e_Institucioneve_Publike_an.pdf). (qasur më 4 tetor 2013).

⁸³ Shih vegzën për faqet e internetit të komunave në: <http://kk.rks-gov.net/> (qasur më 2 tetor 2013).

detyrimet përkitazi me përdorimin e gjuhëve, qoftë edhe nëse nganjëherë përkthimet botohen me vonesa. Komuna e Mamushës, versionin në turqisht të faqes së vet të internetit e ka të plotë, derisa informatat e pasqyruara në versionet në serbisht dhe shqip nuk janë të plota. Komuna e Prizrenit nuk ka fare version në boshnjakisht të faqes së vet të internetit dhe versionin në serbisht nuk e përditëson rregullisht, ndërsa vegëza për versionin në turqisht nuk hapet fare. As komuna e Dragashit, as ajo e Pejës, nuk kanë version në boshnjakisht të faqes së internetit, madje kjo e fundit nuk e ka as në serbisht.⁸⁵ Në komunat tjera që kanë qenë pjesë e anketës, faqet e internetit janë në përgjithësi në mospërputhje me kuadrin ligjor, nga që janë vetëm në një gjuhë ose, kur janë teknikisht të disponueshme në gjuhët zyrtare, kanë mangësi të shumta sikurse përditësimet e rralla, cilësia e dobët e përkthimeve apo pjesët e mangëta.

Veç të tjerash, faqet e internetit të komunave shërbejnë për t'ju siguruar më tepër mundësi komuniteteve, që nuk janë të përfaqësuara sa duhet, për t'u punësuar në shërbimin civil dhe, kështu, është me rëndësi që të jenë në pajtim me detyrimet mbi përdorimin e gjuhëve.⁸⁶ Megjithatë, përmes monitorimit të vet, OSBE-ja ka gjetur që vetëm 19 komuna⁸⁷ e respektonin detyrimin për t'i publikuar konkurset për vende të lira pune në të gjitha gjuhët zyrtare.

Përmbledhje e gjetjeve

Të gjitha komunat e kanë krijuar faqen e vet të internetit, por këto faqe janë kryesisht vetëm në njërin gjuhë zyrtare dhe nuk i përmbushin as për së afërmi detyrimet e komunave për ta lehtësuar qasjen në dokumente dhe shërbime në të gjitha gjuhët zyrtare. Komunat duhet të sigurojnë që gjithë dokumentet dhe shërbimet që publikohen në faqe zyrtare të internetit të jenë në pajtim me detyrimet mbi përdorimin e gjuhëve, përfshirë këtu edhe shpalljet për vende të lira pune.

4.6. Disponueshmëria e përkthimit me gojë dhe kapaciteti i njësive komunale të përkthyesve

Ndonëse Ligji për përdorimin e gjuhëve nuk e përcakton shprehimisht, për zbatimin e tij kërkohen burime adekuate njerëzore, financiare dhe teknike, duke përfshirë këtu edhe krijimin e njësive për përkthim, punësimin e numrit të mjaftueshëm të asistentëve të kualifikuar gjuhësor, dhe mundësi për qasje në kushte të duhura të punës dhe ngritje profesionale.

⁸⁴ Graçanicë, Kamenicë, Kllokot, Novobërdë, Ranillug, Shtërpcë dhe Vushtrri.

⁸⁵ Vlerësim të faqeve të internetit të komunave ka bërë edhe Institucioni i Avokatit të Popullit në Kosovë në raportin e vet sipas detyrës zyrtare nr. 275/2012.

⁸⁶ Për ta rritur përfaqësimin e komuniteteve, institucionet punëdhënëse kanë detyrimin pozitiv për të zbatuar një strategji aktive të rekrutimit, përfshirë edhe përmes botimit të shpalljeve për vend pune, përmes shtypit dhe medieve transmetuese, në të gjitha gjuhët zyrtare. Shih Rregulloren nr. 04/2010 për procedurat e përfaqësimit të drejtë dhe proporcional të komuniteteve joshumicë në shërbimin civil të Kosovës, shënimi i 68-të më sipër, nenet 11.2 dhe 11.3.

⁸⁷ Dragash, Fushë Kosovë, Graçanicë, Istog, Kamenicë, Kllokot-, Lipjan, Mamushë, Novobërdë, Obiliq, Prishtinë, Prizren, Rahovec, Ranillug, Shtime, Shtërpcë, Suharekë, Viti dhe Vushtrri.

Që nga prilli i vitit 2014, 15 komuna kanë raportuar të kenë themeluar njësitë komunale të përkthimit⁸⁸, derisa 15 komuna tjera punojnë më një apo dy asistentë gjuhësor⁸⁹. Komunat si Hani i Elezit, Glllogoc, Malisheva dhe Gjakova nuk kanë përkthyes zyrtarë me shkrim. Vlen të ceket që njëzia komunale e përkthimit në Shtime nuk e parasheh pozitën e përkthyesit me shkrim ose me gojë dhe në vend të kësaj është e përbërë nga shërbyes civil pa njohuri përkatëse të gjuhës.⁹⁰

Nëntëmbëdhjetë komuna⁹¹ kanë raportuar që nuk kanë personel të mjaftueshëm për ofrimin e shërbimeve të përkthimit për shkak të një kombinimi të disa faktorëve, përfshirë kufizimet në numrin e personelit, mungesa e buxhetit, si dhe vështirësitë në gjetjet e aplikuesve të kualifikuar. Në ato raste, përkthyesit e komunave kanë pasur ngarkesë të madhe me punë derisa në disa raste përkthimi me shkrim është bërë nga zyrtarë komunal të cilët nuk kanë poseduar kualifikimet e duhura, në dëm të cilësisë së përkthimit.⁹² Mungesa e personelit të përkthyesve gjithashtu ndikon negativisht edhe në përkthimin me kohë të dokumenteve.

Mangësi shtesë që janë vërejtur në tërë Kosovën janë, mungesa e zyrave adekuate dhe pajisjeve themelore teknike për përkthyesit, përfshirë fjalorët, programet e kontrollimit të drejtshkrimit apo mjetet e incizimit. Përkundër kësaj, vetëm komuna e Ferizajt ka raportuar që rregullisht ndanë burime financiare për rritjen e kapaciteteve të përkthyesve, derisa komuna e Deçanit ka blerë pajisje të reja të teknologjisë informative për njësinë e përkthimit gjatë vitit 2013. Përfundimisht, OSBE-ja ka vërejtur që përkthyesve të komunave shpesh u mungojnë kualifikimet dhe përvoja e duhur⁹³, dhe më tepër se gjysma e përkthyesve të intervistuar e kanë shprehur dëshirën për vijimin e trajnimeve të specializura.

⁸⁸ Komunat: Deçan, Ferizaj, Fushë Kosovë, Gjilan, Istog, Junik, Lipjan, Novobërdë, Podujevë, Prishtinë, Prizren, Skenderaj, Shtime, Shtërpçë dhe Vushtrri.

⁸⁹ Komunat: Dragash, Graçanicë, Kaçanik, Kamenicë, Klinë, Klllokot, Mamushë, Mitrovicë e Jugut, Obiliq, Partesh, Pejë, Rahovec, Ranillug, Suharekë dhe Viti.

⁹⁰ Komisioneri për Gjuhët i Kosovës e ka përfshirë këtë çështje në raportin vjetor të vitit 2013 të dorëzuar në Bordin për Politika Gjuhësore, në bazë të Rregullores nr. 07/2012 për themelimin e Komisionerit për Gjuhët (neni 18).

⁹¹ Komunat: Dragash, Gjilan, Graçanicë, Kaçanik, Kamenicë, Klinë, Lipjan, Mitrovicë jugore, Podujevë, Prishtinë, Prizren, Podujevë, Rahovec, Ranillug, Skenderaj, Shtime, Viti dhe Vushtrri.

⁹² Për shembull në komunën e Vushtrrisë, përkthimi i dokumenteve (i atyre nga niveli qendror të pranuar në gjuhën shqipe dhe serbe) në gjuhën turke, që është gjuhë në përdorim zyrtar, ofrohet nga një asistent administrativ i përkatësisë turke të Kosovës; në komunën e Suharekës, përkthimi me gojë gjatë grupit punues komunal për kthim, behet nga shefi i zyrës komunale për komunitete dhe kthim; në komunën e Gjakovës, zyrtari ligjor komunal ofron shërbime të përkthimit kur një gjë e tillë kërkohet. Nga shtatori i vitit 2012 deri në prill të vitit 2013, komuna e Klinës nuk ka pasur përkthyes dhe përkthimi është siguruar nga anëtarët e zyrës komunale për komunitete dhe kthim sipas nevojës.

⁹³ Vetëm tre përkthyes të intervistuar kanë raportuar ta kenë kryer fakultetin e përkthimit, 17 nga ta kanë raportuar të kenë të kryer fakultetin derisa 24 e kishin të kryer vetëm shkollën e mesme. Mungesa e përvojës ishte kryesisht e dukshme në vështirësitë me përdorimin e terminologjisë juridike, që shpesh rezultonte me dhënie të kuptimit tjetër në përkthimin e dispozitave.

Siç ka rekomanduar OSBE-ja në raportet e mëparshme⁹⁴, një zgjidhje e mundshme e këtyre problemeve mbetet forcimi i rolit të ri të Institutit të Kosovës për Administratë Publike si institucioni kryesor i trajnimit, përgjegjës për trajnime të përgjithshme të shërbyesve civil të Kosovës, dhe për rishikimin dhe vlerësimin periodik të nevojave të trajnimit të shërbyesve civil.⁹⁵

Përmbledhje e gjetjeve

Komunat mbeten të paafta për zbatimin e plotë të Ligjit për përdorimin e gjuhëve për shkak të faktit që ato ende kanë numër të vogël të personelit për ofrimin e shërbimeve të përkthimit me gojë dhe me shkrim. Numri i pamjaftueshëm i përkthyesve, kualifikimet joadekuate dhe kushtet joadekuate të punës shpesh shpijnë në përkthime të cilësisë së ulët. Njësitë komunale të përkthimit duhet të themelohen në tërë Kosovën me personel të kualifikuar dhe kushte adekuate të punës. Instituti i Kosovës për Administratë Publike duhet të luajë rol kyç në rritjen e aftësive të përkthyesve brenda shërbimit civil.



Shenjë rrugore në komunën e Gjilanit/Gnjilane, 28 maj 2014 – OSCE/Enis Ahmetaj

⁹⁴ Raporti i OSBE-së *Legjislacioni shumëgjuhësh në Kosovë dhe sfidat e tij*, shënimi 3, *supra*, në faqen 20.

⁹⁵ Mandati i Institutit të Kosovës për Administratë Publike është rregulluar me Urdhëresën Administrative të UNMIK-ut nr. 2003/25 për zbatimin e Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/09 për Degën Ekzekutive të Institucioneve të Përkohshme Vetëqeverisëse në Kosovë.

4.7. Ekspozimi i emrave të rrugëve dhe shenjave në shumë gjuhë

Sipas nenit 9.2 të Ligjit për përdorimin e gjuhëve: “Shenjat zyrtare që shënojnë apo përfshijnë emrat e komunave, fshatrave, rrugëve, rrugicave dhe të vendeve të tjera publike, paraqiten në gjuhët zyrtare dhe në gjuhët e komuniteteve, gjuha e të cilave e ka statusin e gjuhës zyrtare në komunë, në pajtueshmëri me nenin 2.3.” Gjithashtu, sipas Ligjit për vetëqeverisje lokale, komunat kanë kompetenca të plota dhe ekskluzive për të emëruar rrugicat, rrugët dhe vendet tjera publike në komunë.⁹⁶

Përkitazi me emrat dhe shenjat e rrugëve, OSBE-ja ka gjetur që nuk është shënuar ndonjë përparim i madh që nga vlerësimet e mëparshme të OSBE-së⁹⁷ meqë ende ka shumë pak shenja të rrugëve në zona rurale, fshatra dhe lagje. Derisa ato në përgjithësi e respektojnë formatin “Ul/Rr./Street”, shenjat e rrugës shpesh nuk janë në pajtim me kriteret ligjore, për shembull, duke i ekspozuar emrat e vendeve vetëm në një të gjuhë zyrtare apo duke i shqiptuar gabimisht emrat zyrtar. Për më tepër shumë shenja të kufijve administrativ të komunave dhe fshatrave me sa duket janë hequr, shkatërruar apo janë bërë të palexueshme dhe nuk janë pastruar apo zëvendësuar nga autoritetet komunale. Mirëpo, vetëm komuna e Shtërpçës ka raportuar që haptazi e ka dënuar dëmtimin e shenjave⁹⁸, dhe vetëm disa komuna kanë raportuar të kenë ndërmarrë veprime për pastrimin apo zëvendësimin e shenjave të dëmtuara apo të palexueshme, veçanërisht në Gjilan⁹⁹, Mitrovicën e Jugut¹⁰⁰ dhe Prizren¹⁰¹. Si një rast pozitiv, gjithsej 18 komuna¹⁰² kanë themeluar komisione të përhershme komunale për emërimin e rrugëve dhe hapësirave tjera publike. Komuna e Gjilanit dhe ajo e Vitisë, kanë raportuar se janë duke punuar përmes komisioneve të themeluara *ad hoc*. Ndonëse komuna e Shtërpçës nuk ka komision për emërimin e rrugëve, ajo është në proces të emërimit të rrugëve dhe të instalimit të shenjave të rrugëve (në alfabetin shqip dhe atë serbisht cirilik) si pjesë e një projekti të financuar nga bashkësia ndërkombëtare.¹⁰³

⁹⁶ Ligji për Vetëqeverisje, shënimi 73, supra, Nenet 17 (o) dhe 40.2 (j).

⁹⁷ Raporti i OSBE-së *Zbatimi i Ligjit për përdorimin e gjuhëve nga komunat e Kosovës*, korrik 2008, shënimi 3, supra, <http://www.osce.org/kosovo/32762>; OSBE Raporti i vlerësimit për të drejtat e komuniteteve, shënimi 3, supra, faqet 30–31.

⁹⁸ Nënkrjetari i Shtërpçës për komunitete dhe zyrtari komunal për informim kanë raportuar që në një rast në vitin 2013 komuna e ka dënuar dëmtimin e shenjave rrugore në hyrje të një fshati të banuar kryesisht me shqiptar të Kosovës që quhet Firajë (emir në gjuhën Serbe ishte bërë i palexueshëm). Dënimi ishte bërë në formë të deklaratës së dhënë në redaksitë e mediave lokale. Informatat iu janë dhënë OSBE-së gjatë intervistës së bërë më 10 shkurt 2014.

⁹⁹ Drejtori i departamentit komunal për shërbime publike ka theksuar që shenjat në Gjilan kontrollohen dhe zëvendësohen rregullisht. OSBE-ja e ka vërejtur vetëm një shenjë të dëmtuar në vendin e saj (Përlepnice) që nga marsi i vitit 2013.

¹⁰⁰ Informatë e dhënë nga drejtori i Drejtorisë komunale për shërbime publike dhe e konfirmuar përmes monitorimit të rregullt nga OSBE-ja.

¹⁰¹ Informatë e dhënë nga drejtori i Drejtorisë komunale për shërbime publike dhe e konfirmuar përmes monitorimit të rregullt nga OSBE-ja, ndonëse shenjat nuk janë pastruar/zëvendësuar menjëherë pas dëmtimit të tyre.

¹⁰² Komunat: Deçan, Dragash, Fushë Kosovë, Gjakovë, Gllogoc, Junik, Kamenicë, Kllokot-, Mitrovicë e Jugut, Novobërdë, Podujevë, Prishtinë, Prizren, Ranillug, Skenderaj, Shtime, Suharekë dhe Vushtrri.

¹⁰³ Projekt i Agjencisë së Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar “Nisma për komuna demokratike efektive”.

Përmbledhje e gjetjeve

Shumica e komunave nuk i kanë respektuar obligimet e tyre gjuhësore për emrat dhe shenjat e rrugëve, të cilat shpesh kanë shqiptim të gabuar, janë të dëmtuara apo janë bërë të palexueshme. Komunitetet duhet të vendosin shenja të rrugëve që i respektojnë kriteret gjuhësore dhe menjëherë ta rregullojnë, dënojnë zyrtarisht dhe sanksionojnë në mënyrë adekuate çdo prishje apo shkatërrim të shenjave.

5. PËRFUNDIMET

Më shumë se shtatë vite pas nxjerrjes së tij, Ligji për përdorimin e gjuhëve vazhdon të zbatohet vetëm pjesërisht si pasojë e burimeve të pamjaftueshme njerëzore dhe financiare, që shpeshherë shoqërohen me të kuptuar të pamjaftueshëm të obligimeve komunale dhe mungesë të vullnetit politik.

Në nivel qendror, OSBE-ja i mirëpret reformat që garantojnë sigurimin e burimeve adekuate njerëzore, logjistike dhe financiare për Zyrën e Komisionerit për Gjuhët, ndonëse themelimi i Rrjetit për Politika Gjuhësore është vonuar përtej afatit të duhur kohor.

Në nivel komunal, të gjitha komunitetet kanë ndërmarrë hapa pozitivë duke miratuar rregullore komunale për përdorimin e gjuhëve, ndonëse pa mbajtur debate publik apo pa përpjekje të ndërgjegjësimit për të informuar popullatën rreth të drejtave gjuhësore. Përveç kësaj, përdorimi i komunitetit të ndryshme e kanë njohur gjuhën boshnjake dhe/apo turke si gjuhë zyrtare apo gjuhë në përdorim zyrtar, gjuhës romë ende i mungon një njohje dhe mbrojtje e tillë, përkundër faktit që kualifikohet për një gjë të tillë.

Shumica e komunave nuk vendosin shenja shumëgjuhëshe në zyrat publike të komunës. Anëtarët e komuniteteve në pakicë numerike në nivel komunal vazhdojnë të ballafaqohen me probleme si në komunikimin verbal ashtu edhe atë me shkrim me administratën publike, kur e përdorin gjuhën e tyre amtare, si dhe kur ato e kanë statusin e gjuhëve zyrtare apo gjuhëve në përdorim zyrtar në nivel komunal. Ato mangësi, vijnë kryesisht për shkak të vështirësive në punësimin e shërbyesve civilë që i njohin mirë gjuhët zyrtare dhe nivelin joadekuat të përfaqësimit të disa komuniteteve në shërbimin civil, si dhe mungesës së trajnimit adekuat gjuhësor për shërbyesit civilë – veçanërisht atyre që ofrojnë shërbime përkthimi në komuna.

Ndonëse komunitetet i kanë rritur kapacitetet e tyre për të ofruar përkthim me gojë gjatë seancave të kuvendit komunal, ende ka përkthime joadekuate të dokumenteve siç janë procesverbalet e takimeve dhe aktet ligjore komunale, për shkak të burimeve të pamjaftueshme njerëzore dhe mungesës së vullnetit politik. Faqet e internetit të komunave gjithashtu vazhdojnë të jenë kryesisht njëgjuhëshe, apo nuk e plotësojnë obligimin e komunës për lehtësimin kuptimplotë të qasjes në dokumente dhe shërbime në të gjitha gjuhët zyrtare në komunë.

Ndonëse, shumica e komunave i kanë themeluar njësitë e përkthimeve apo kanë asistentë të gjuhës, përkthimet me shkrim të cilësisë së dobët kanë ardhur si rezultat i një numri të problemeve, përfshirë këtu mbingarkesën me punë, numrin e pamjaftueshëm të përkthyesve, kualifikimet joadekuate dhe kushtet joadekuate të punës. Përkundër këtyre mangësive, asnjë institucion i nivelit qendror e as ndonjë komunë nuk ka ofruar mundësi trajnimi për përkthyesit.

Shumica e komunave, nuk i kanë plotësuar obligimet e tyre gjuhësore përkitazi me emrat dhe shenjat e rrugëve komunale, dhe nuk kanë ndërmarrë nismat e nevojshme për t'i rregulluar ato pasi që ato janë dëmtuar, janë bërë të palexueshme apo janë shqiptuar keq.

6. REKOMANDIME

Për komunat e Kosovës

1. Të realizohen fushata publike të ndërgjegjësimit lidhur me Ligjin për përdorimin e gjuhëve dhe rregulloreve përkatëse komunale, si dhe të ndahen burime adekuate financiare, njerëzore dhe teknike për ta siguruar zbatimin e tyre të plotë;
2. Të ndërmarrin hapa për ta respektuar Rregulloren nr. 07/2012 e cila kërkon caktimin e personave kontaktues në secilën komunë, kontaktet e së cilëve duhet të ndahen me Zyrën e Komisionerit për Gjuhët. Në të njëjtën kohë, institucionet komunale duhet ta njoftojnë Zyrën e Komisionerit për Gjuhët me detajet e të gjithë asistentëve gjuhësorë dhe përkthyesve që punojnë për to;
3. Të sigurohen që të gjitha shenjat komunale dhe njoftimet të ekspozohen në të gjitha gjuhët zyrtare apo gjuhët në përdorim zyrtar, siç kërkohet në zbatim të plotë të Ligjit për përdorimin e gjuhëve;
4. Të merret parasysh njohuria e gjuhës gjatë procedurës së punësimit, si dhe të kërkohet mbështetje nga niveli qendror në mënyrë që shërbyesve civilë tu sigurohen aftësi adekuate gjuhësore, me qëllim që të sigurohet ofrimi i shërbimeve në shumë gjuhë, siç kërkohet me nenet 7.2 dhe 8.1 të Ligjit për përdorimin e gjuhëve;
5. Të ndajnë burime njerëzore dhe financiare për ta ngritur cilësinë e përkthimeve të kërkuara me gojë, gjatë të gjitha takimeve publike, obligim ky i paraparë me nenet 7.3 dhe 8.4 të Ligjit për përdorimin e gjuhëve;
6. Të gjitha dokumentet komunale, përfshirë edhe projektaktet komunale, të mbahen dhe lëshohen në të gjitha gjuhët zyrtare, me qëllim që të lehtësohet dhe inkurajohet pjesëmarrja e të gjitha komuniteteve në procesin e hartimit dhe në çështjet tjera publike, siç kërkohet me nenin 7.6 të Ligjit për përdorimin e gjuhëve;

7. Të sigurojnë që faqet e internetit të komunave të jenë në të gjitha gjuhët zyrtare të komunave përkatëse, obligim ky sipas nenit 7.2 dhe 7.4 të Ligjit për përdorimin e gjuhëve dhe Udhëzimit Administrativ nr. 03/2011 të Ministrisë së Administratës Publike;
8. Të sigurojnë që njësitë e përkthimeve themelohen në secilën komunë dhe të njëjtat të pajisen me numër të mjaftueshëm të personelit të kualifikuar dhe kushte adekuate të punës (p.sh. zyrë dhe pajisje, fjalorë, kompjuterë dhe programe kompjuterike), si parakusht për zbatimin e plotë të Ligjit për përdorimin e gjuhëve;
9. Të marrin masa të menjëhershme për vendosjen e shenjave shumëgjuhëshe rrugore, në të gjitha gjuhët zyrtare në komunat përkatëse, siç kërkohet me nenin 9.2 të Ligjit për përdorimin e gjuhëve;
10. Menjëherë ta rregullojnë, të lëshojnë komunikata zyrtare të dënimit të dhe sanksionojnë çdo prishje apo shkatërrim të shenjave shumëgjuhëshe të rrugëve dhe rrugicave.

Për Institutin e Kosovës për Administratë Publike

11. Të ndërmerren aktivitete trajnimi për të siguruar që komunat kanë njohuri të plotë lidhur me kornizën relevante ligjore dhe politikat që kanë të bëjë me përfaqësimin e barabartë të komuniteteve në shërbimin civil, me theks të veçantë në masat pozitive të veprimit që kërkohen me rregulloren nr. 04/2010.
12. Të zhvillohen dhe ofrohen programe për avancimin e njohurive të përkthyesve në kuadër të shërbimit civil, duke ofruar trajnime dhe aftësime profesionale të certifikuara për shkathtësitë e avancuara të përkthimit me gojë dhe me shkrim.

Për Ministrinë e Administratës Publike

13. T'i monitorojë dhe udhëzojë komunat për të siguruar zbatim të duhur të UA-së nr. 03/2011 për faqet e internetit të institucioneve publike.

Për Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal

14. Të ofrojë këshilla dhe udhëzime për komunat lidhur me obligimet e tyre për pranimin e statusit të barabartë dhe përdorimin e barabartë të gjuhëve zyrtare në punën e tyre, në veçanti për hartimin dhe publikimin e legjislacionit të nivelit lokal në të gjitha gjuhët zyrtare, në pajtim me nenet 7.3, 7.6 dhe 8.4 të Ligjit për përdorimin e gjuhëve.

Për Zyrën e Komisionerit për Gjuhët

15. Të ndërmerr masa për ngritjen e ndërgjegjësimit të të gjitha komuniteteve dhe opinionit publik për të drejtat gjuhësore, si dhe rolin dhe mandatin e Zyrës së

Komisionerit për Gjuhët, përfshirë mekanizmat për ankesa në dispozicion siç janë paraparë me Rregulloren 07/2012 për Zyrën e Komisionerit për Gjuhët;

16. T'i shtojë përpjekjet për monitorimin e respektimit nga ana e institucioneve të Kosovës të obligimeve gjuhësore të përvijuara në Ligjin për përdorimin e gjuhëve;
17. T'i monitorojë dhe udhëzojë komunitetet në procesin e emërimit të personave kontaktues me qëllim të themelimit të një Rrjeti funksional për politika gjuhësore, siç është paraparë me Rregulloren 07/2012 për Zyrën e Komisionerit për gjuhë.

Për bashkësinë ndërkombëtare

18. Të vazhdojë të avokojë tek institucionet e Kosovës për respektimin e obligimeve ligjore si element kyç për mbrojtjen e të drejtave të komuniteteve dhe vlerave pluraliste demokratike të Kosovës.

Respektimi i të
drejtave gjuhësore nga
komunitat e Kosovës

